



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-SC-2023-01

Vendosi: Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme
Kryegjykatëse Ekaterina Trendafilova
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart
Gjykatës Daniel Fransen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Afatet e Parashtrimeve

**Ushtruesit të Detyrës së
Prokurorit të Specializuar:**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hysni Gucatit:
Xhonathan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:
Tobi Kadman

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”), në bazë të nenit 48(6) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullave 9(5)(a) dhe 76 dhe Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 dhe 3 maj 2023, z. Nasim Haradinaj dhe z. Hysni Gucati parashtruan kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë (“Kërkesat”).¹

2. Më 4 maj 2023 u caktua Paneli i Gjykatës Supreme për gjykimin e Kërkesave.²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Rregulla 76 e Rregullores parasheh se “[p]ërveçse nëse përcaktohet ndryshe në Rregullore, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes”.

4. Rregulla 193(1) e Rregullores parasheh se kërkesa në përputhje me nenin 48(6) të Ligjit dorëzohet brenda 90 ditësh nga vendimi ose gjykimi përfundimtar, ndaj të cilit kërkohet mbrojtje e ligjshmërisë.

III. DISKUTIM

5. Paneli vëren se, përveç dispozitës së përgjithshme mbi afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores, në Rregullore nuk përcaktohen afate specifike, brenda të

¹ F00001, Kërkesa e Mbrojtjes së Haradinajt për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, 2 maj 2023, me Shtojcë; F00002, Kërkesa e Gucatit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë sipas nenit 48(6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores, 3 maj 2023 (konfidenciale), me Shtojcë.

² F00003, Vendimi për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 4 maj 2023.

cilave palët dorëzojnë përgjigje dhe kundërpërgjigje ndaj kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë në përputhje me nenin 48(6) të Ligjit. Duke pasur parasysh llojin dhe kuadrin e këtyre Kërkesave, Paneli çmon se, në këtë rast specifik, është në interes të drejtësisë që të vendosë afate për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet ndaj këtyre Kërkesave, nëse do të ketë të tilla.

6. Më tej, Paneli vëren se z. Gucati e ka klasifikuar kërkesën e tij si konfidenciale. Paneli risjell në vëmendje rëndësinë e garantimit të zhvillimit të procedimeve në mënyrë të hapur për publikun, duke përfshirë edhe parashtrimet e protokolluara, me përjashtim të rasteve kur nevojitet ndryshe. Mbi këtë bazë, Paneli e udhëzon z. Gucati të dorëzojë një version të redaktuar publik të kërkesës së tij.

IV. VENDIM

7. Bazuar mbi sa më lart, Paneli:

- a). **URDHËRON** Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) të dorëzojë një përgjigje ndaj Kërkesave, nëse do të ketë një të tillë, brenda 60 ditësh nga njoftimi i këtij vendimi;
- b). **URDHËRON** z. Gucati dhe z. Haradinaj të dorëzojnë kundërpërgjigjet përkatëse ndaj përgjigjes së ZPS-së, nëse do të kenë të tilla, brenda 30 ditësh nga marrja e përgjigjes;
- c). **URDHËRON** z. Gucati të dorëzojë një version të redaktuar publik të kërkesës së tij për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda shtatë ditësh nga njoftimi i këtij vendimi.

/nëshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryegjykatëse

E enjte, 4 maj 2023
Hagë, Holandë